

Hapet Thirrja për mobilitet stafi të UPT-së në kuadër të marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në University of Oradea, Rumani.

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikim për bursë për mobilitet për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, (Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), në University of Oradea.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit për trajnim (Staff training).

Kohëzgjatja e bursës:

- Training – 5 ditë (+ 2 ditë udhëtim).

Numri total i stafit për trajnim: 1

Dokumentat e nevojshme për aplikim për trajnim për stafin:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Diploma e nivelit të fundit të studimeve.
- Çertifikata e gjuhës së huaj (Niveli minimal i gjuhës angleze B2)
- Aprovim nga Përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për tu kryer në Universitetin pritës *;
- Letra konfirmuese nga Universiteti pritës**;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Training”) ***.

**Plani i mobilitetit për trajnim (training), si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga Përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/ Titullar Departamenti ose program studimi/ Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aproves, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement për Training (trajnim) për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga Përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarte e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: 2 Mars 2022

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al